



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo	
Autoriteti i Konkurrencës Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority	
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No.	631/24-02/0
Nr. i Fq./Br. Sl./No. Fq.	1/3
Data/Idatum/Date:	23.09.2024.
PRISHITINË - PRISTINA - PRISTINA	

Vendimi Nr. 85/24
Datë: 23.09.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas Shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit në mbledhjen e datës, 23.09.24 mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me blerjen e drejtpërdrejtë të 100% të aksioneve mbi Vita Res d.o.o., nga RAUCH Fruchtsäfte GmbH.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 24.07.2024, me Nr. Prot. 475/24-11/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me blerjen e drejtpërdrejtë të 100% të aksioneve të Vita Res DOO, nga RAUCH Fruchtsäfte GmbH.

Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 22.07.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë: 27.08.2024;
3. Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumë 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro;
3. Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve.

Palët në Përqendrim:

RAUCH Fruchtsäfte GmbH, (blerësi), me adresë në Langgasse 1, 6830 Rankweil, Vorarlberg, Austri, e regjistruar me ID nr. FN 68604p, ndërmarrja është aktive që nga viti 1919 dhe aktualisht operon me 14 impiante prodhimi dhe 8 degë në gjithë Evropën dhe SHBA-në, duke ofruar produkte të disponueshme në 100 vende të botës. E njëjta është pjesë e kompanive të RAUCH Group. RAUCH Group, me seli në Austri, fokusohet në tri fusha strategjike të biznesit, respektivisht në prodhimin dhe shitjen e pijeve, duke përfshirë brendet si HAPPY DAY, BRAVO, NATIVA dhe RAUCH ICETEA, ndërmarrja fokusohet dhe në veprimtarinë biznes-për-biznes, që përfshin prodhimin dhe shitjen e koncentreve të lëngjeve të frutave dhe produkteve gjysmë të gatshme për blerësit ndërkombëtarë. RAUCH, po ashtu është e angazhuar dhe në mbushjen me porosi të lëngjeve, ofrimin e shërbimeve për prodhues të tjerë të pijeve duke mbushur kanaçe, PET (plastikë), shishe qelqi dhe paketime të kartonit për pije (p.sh. Tetra Pak). Ndërmarrja e cekur më lartë, nuk ka asnjë filial në Kosovë dhe nuk ka shitje të koncentreve të lëngjeve të frutave apo pureve të frutave, për klientët në Kosovë.

Vita Res d.o.o., (targeti), me adresë 29 Noemvri nr. 1-26 Resen, Maqedoni e Veriut, e regjistruar me numër biznesi nr. 5999774. Kjo ndërmarrje, ushtron veprimtarinë e përpunimit të frutave. Ajo blen fruta, si mollë, qershi, pjeshkë, kumbull, pastaj perime si domate, kjo ndërmarrje prodhon mallra gjysmë të gatshme, gjegjësisht, koncentre të lëngjeve të frutave, pure frutash si dhe kubëza të ngrira molle e qershie. Mallrat gjysmë të gatshme, u shiten klientëve vendorë dhe të huaj që prodhojnë lëngje smoothie dhe pije të tjera, produkte qumështi e furre, akullore dhe produkte tjera. Vita Res nuk ka filiale në Republikën e Kosovës, mirëpo është e fokusuar në shitjen e koncentratit të lëngut të mollës, puresë së mollës dhe puresë së pjeshkës për klientët në Kosovë.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit: Ka të bëjë me përpunimin, shitjen e frutave dhe puresë së frutave, si dhe tregun për prodhimin dhe shitjes së lëngjeve të gatshme.

Tregu gjeografik: Në transaksionin e propozuar është tregu ndërkombëtar, përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Analiza e konkurrencës:

Sa i përket tregut të lëngjeve-pijeve në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, operojnë një numër i madh i prodhuesve vendor dhe përpunuesve të frutave dhe lëngjeve duke ofruar një gamë të gjerë pijeve të cilët mbulojnë një pjesë të madhe të tregut. RAUCH Group është aktiv në segmentin e lëngjeve të frutave, që paraqet një treg të rrjedhës së poshtme të FJC (Fresh Juice Company– Kompani e lëngjeve natyrale), por nuk prodhon në Kosovë dhe nuk ka lidhje furnizimi me këtë treg. Transaksioni i propozuar paraqet mundësi të vlefshme për RAUCH, në zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese, të përpunimit të frutave të nevojshme për prodhimin e mallrave të gatshme nën brendet RAUCH. Rauch nuk ka asnjë filial në Kosovë, nuk prodhon lëngje frutash në vendin tonë dhe nuk ka shitje të koncentreve të lëngjeve të frutave apo pureve të frutave për klientët në Kosovë. Vita Res, po ashtu nuk ka filiale në Kosovë, mirëpo merret me shitjen e koncentratit të lëngut të mollës, puresë së mollës dhe puresë së pjeshkës për klientët në Kosovë. Ky transaksion, nuk rezulton në mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale ndërmjet aktiviteteve të palëve, duke eliminuar kështu çdo shqetësim të mundshëm për konkurrencën. Për këtë arsye, çështja e përcaktimit të saktë të tregut gjeografik, mund të mbetet e hapur.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra palë në transaksion, ka partneritet me Meridian Corporation në Kosovë duke operuar në tregun e pijeve-lëngjeve, përfshirë brendet si HAPPY DAY, BRAVO, NATIVA dhe RAUCH ICETEA. Struktura e tregut të ndërmarrjes blerëse, në tregun e Republikës së Kosovës nuk ndryshon. Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësime për konkurrencën, dhe nuk pritet të ndikojë në konkurrencën në Kosovë, në krijimin apo forcimin e pozicionit dominues.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion/blerja nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndrojë 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

AUTORITETI I KONKURENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

